# VLERËSIMI
# I RREZIQEVE PËR
# TERITORIN E KOMUNËS SE DRENASIT

## DRENAS ; 2010

# Përmbajtja:

Mbështetja Ligjore
1. Hyrja

1.1. Fusha e përgjegjësisë së bartësit të Planifikimit
1.2. Pozita dhe Karakteristikat e terenit të Komunës së Drenasit
1.2.1. Komuna e Drenasit në rajon
1.3 Gjendja e resurseve ujore-lumore
1.4 Malet dhe bjeshkët në Komunën e Drenasit
1.5 Karakteristikat Gjeografike-klimatike të komunës së Drenasit
2.1 Numri i Popullatës,
2.2 Grup Mosha e Popullatës,
2.3 Numri i vendbanimeve ne Komunën e Drenasit
2.4 Numri i të punësuarve,paunësuarve dhe pozionerve,
3. Të mirat materiale,Kulturore dhe të ambientit,
3.1 Vlerat e Trashëgimisë Kulturore,
3.2 Trashëgimia Natyrore,
3.3 Parqet nacionale,natyrore,rezervatet dhe sipërfaqet pyjore,
3.4 Objektet për furnizim me ujë,
3.5 Zonat për prodhim Bujqësor,
4. Numri i zonave dhe objekteve industriale,
4.1 Lokacioni i zonave ,dhe objekteve industrilae në raport me vendbanime,
4.2 Strehimoret për sterhim të përkohëshëm në raste emergjente,
5. Kapacitet mjeksore Publike dhe private,
6. Infrastruktura Shkollore,
7. Infrastruktuara teknologjike dhe e komonikacionit,
7.1 Infrastruktura rrugore në Drenas,
7.2 Rrejti i rrugëve në Drenas,
7.3 Transporti hekurudhor,
7.4 Transpori ajror,
8. Sistemi Elektroenergjetik,
8.1 Gas sjellësi dhe Naftësjellësi,
8.2 Telekomunikimi,
8.3 Gjendja e Deponive të karburanteve,
9. Vlerësimi i Rrezikëshmërisë nga Fatkeqësit natyrore dhe fatkësive tjera,
a) Metodologjia e Vlerësimit të rrezikut
b) Procedura e vlerësimit të rrezikut,
9.1. Vlerësimi i rrezikëshmëris nga Vershimet,
9.2 Vlerësimi i rrezikëshmëris nga Thatësit,
10. Vlerësimi i rrezikëshmëris nga Fatëkeqësitë Tekniko-teknologjike,
10.1 Vlerësimi i rrezikëshmëris nga zjarret në objkete banimi dhe zjarre fushore,
11. Masat prevenive nga Vërshimet,
11.1 Masat prevenive nga Thatësit,
11.2 Masat prevenive nga zjarret nëpër deponit e lëndeve lehtëndezëse dhe objekteve të rendësis së veqant dhe zjarreve fushore

# Mbështeja ligjore

**Plani për Vlerësimin e rrezikut në teritorin e Komunës së Drenasit mbeshtetët në nenin 82 në Statutin e komunës ,nenin 5 pika 5.2 të "Ligjit për Mbrojtje kundër Zjarrit nr,02/L-41", nenit 31,pikat, 5,9 , nenit 38 pika 38.3 të Ligjit për Mbrojtje nga Fatkeqësit Natyrore dhe Fatkeqësit Tjera dhe Udhëzimit Administrativ nr 19/2008,neneve 3,4,dhe 5.**

# HYRJE

Hartimi i vlerësimit të rrezikut për territorin e Komunës së Drenasit nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera shërben si udhëzues për identifikimin e shkallës së rrezikshmërisë nga faktorët potencial, planifikimin e masave parandaluese për pengimin dhe zvogëlimin e dëmeve në raste të fatkeqësive eventuale, përfshirja dhe trajnimi i të gjitha strukturave dhe shërbimeve gjegjëse komunale me qëllim të koordinimit të aktiviteteve në raste të fatkeqësive – katastrofave si dhe angazhimin e forcave për mbrojtje dhe shpëtim me qëllim të ndihmës, vet ndihmës, shpëtimit, evakuimit dhe strehimit të rrezikuarve dhe zvogëlimin e dëmeve materialo-teknike, sigurimin e kushteve për institucionet Komunale dhe atyre të cilat veprojnë në territorin e Komunës për veprimtari ekonomike, për kalimin nga gjendja normale e jetës dhe punës në një situatë emergjente.

## 1.1 Fusha e përgjegjësisë së bartësit të Planifikimit

Bartës i përgjegjësive për hartimin e Planit për Vlerësimin e Rrezikut në Drenas është **D**rejtoria për **S**herbime **P**ublike dhe **E**mergjencë e cila është përgjegjëse për menaxhimin e emergjencave të nivelit Komunal, vënien e standardeve të kryerjes së punëve lidhur me Gatishmërinë Civile dhe Reagimit Emergjent në territorin e vet dhe koordinimin e të të gjitha subjekteve relevante për reagim në Situata Emergjente, varësisht nga karakteri dhe përmasat e fatkeqësisë .

Kjo Drejtori planifikon që të merr masa të nevojshme për parandalimin e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera si dhe përcjell aktivitetet e subjekteve relevante dhe involvuese në rastë të fatëkeqësive dhe të cilët do të mbështesin **shërbimet emergjente** në rast fatkeqësive.

# 1. Pozita dhe karakteristikat e territorit të komunës së Drenasit

## 1.2 Pozita dhe Sipërfaqëja totale e komunës së Drenasit

Komuna e Drenasit, ka një sipërfaqe prej 275,60 km$^2$ ose 27.449,10 ha, me një lartësi mbidetare prej 575 m pika më e ulët dhe 1072 pika më e lartë. Drenasi shtrihet në pjesën e Kosovës qendrore, dhe bënë pjesë në grupin e komunave të mesme të vendit.

Komuna e Drenasit shtrihet në pjesën e Kosovës qendrore, në luginën e Drenicës, 32 km nga Prishtina. Territori i saj , shtrihet në mes të Rrafshit të Kosovës dhe atij të Dukagjinit. Territori i Komunës së Drenasit është një urë lidhëse në mes të këtyre dy rajoneve.

Territori i Komunës së Drenasit rrethohet me Malet e Berishës në pjesën Jug-Perëndimore, Kasmaqit në pjesën perëndimore, Qyqavicës në pjesën Veriore, Goleshit dhe Lipovicës (Blinajës) në pjesën Jug- Lindore. Këto male shtrihen në të dy anët e Luginës së lumit Drenica.

Në vitin 1981 vendbanimi i Drenasit shpallët qytet, e me këtë edhe qendra kryesore administrative, kulturore, sociale dhe ekonomike e komunës.

**Harta nr.1 Pozita e Drenasit në Kosovë**






Punoj:Afrim Prokshi

## 1.3 Gjendja e resurseve ujore-lumore

Për gjatë territorit të Komunës së Drenasit kalon lumi **Drenica** i cili shtrihet në vijat:Nekoc-Drenas,Polluzhë-Drenas dhe Drenas-Dobroshec,me gjatësinë afër 30km,
Por në përiudhat e nxehta të verës disa degë të tijë shterren,deri në periudhat me lagështi.
Ndërsa në fshatin Vasilevë gjindet liqejt arficial të cilët janë krijuar nga nxjerrjet e thengjillit nga KEK-u, të cilët në përiudhat me shi kanë sasi më të madhe të ujit ndërsa në ato më thatësi kanë sasi me të vogël.

**Harta nr.2 Lumenjet dhe liqejt në Drenas**




## 1.4 Malet dhe bjeshkët në Komunën e Drenasit

Territori i Komunës së Drenasit rrethohet me Malet e Berishës në pjesën Jug-Perëndimore, Kasmaqit në pjesën perëndimore, Qyqavicës në pjesën Veriore, Goleshit dhe Lipovicës (Blinajës) në pjesën Jug- Lindore. Këto male shtrihen në të dy anët e Luginës së lumit Drenica.Sipërfaqëja totale e pyjeve është **10895** ha




**Harta nr.3 Shtrirja e Maleve në komunën e Drenasit**

## 1.5 Karakteristikat Gjeografike-klimatike të komunës së Drenasit

Në Komunën e Drenasit dominojnë terrenet kodrinore malore si dhe terrenet e rrafshëta. Gjeografikisht përfshinë pjesën qendrore te Kosovës (Luginën e Drenicës) dhe kufizohet me vargmalet e Drenicës, Kosmaqin, Qyqavicen, Goleshin dhe Lipovicen.

Klima është e mesme kontinentale dhe mesatarja e temperaturave vjetore sillet rreth 11 gradë C.

Muaji me i nxehte është Korriku me temperaturën prej 20-21 gradë C, ndërsa muaji me ftohte muaji Janar prej -1.4 deri në - 2.3 gradë C

Gjerësia gjeografike 42 (shkallë) 32"

Gjatësia gjeografike 42 (shkallë) 64"

Lartësia Mbidetare 640 – 840 m.

Pjerrtësia e terrenit 10 – 35 %

Erërat dominante: Në territorin e Drenasit zakonisht si erë dominante është jugu, si dhe erërat me kahje veriore.

Forca e erërave: 2.6 gjegjësisht 2.8 Bosfor.

Shpejtësia e erërave: prej 4.4 deri në 9.5 m/sek.

Dominimi i lartë i veprimit të këtyre erërave në qytetin e Drenasit, vërehet në periudhën janar-prill.
Lagështija relative e ajrit gjatë vitit sillet nga 70.5% deri në 82%.
Shtypja atmosferike Brenda vitit sillet nga 946-949 mb
Të reshurat atmosferike brenda vitit sillen nga 580-800 ml/m $^2$

**Erozionet natyrore**
Janë prezente në terrenet malore te malet e Çiçavicës, Kosmaqit -erozioni vertikal.
Në luginën e Drenicës – erozioni anësor

**Erozionet Artificiale**
Në mihjet sipërfaqësore në Çikatovë të vjetër, Korreticë të lartë dhe Baicë.

Termetet
Territori i komunës është në zonën sizmike prej 7 shkallëve të MCS deri në 8 shkallë të MCS.
Për zonat mikro- sizmike nuk ka të dhëna. Zona sizmike kryesisht është ajo veri-lindore.

**Harta. 4: Harta e zonave maksimalisht të rrezikuara nga tërmetet në Kosovë dhe gjatësia dhe gjerësia gjeografike Burimi: Plani Hapësinor i Kosovës**

## 2. Struktura demogtrafike e komunës së Drenasit

### 2.1 . Numri i Popullësis

Në komunën se Drenasit numri i tërsishëm i banorve është rrethë 78300, ndërsa dendësia për Km² është 284.1 banore,ose 2.84 banore për Ha.Prandaj shtimi natyrorë vjetorë është më i madh se ai i Kosovës, ku këtë e vërteton edhe vlerësimi i punuar nga KK. Drenas,që po e paraqesim në tab.

**Tab. 4: Vlerësimi i numrit të banorëve sipas viteve**

| Viti | Numri i Banorëve | Shkalla vjetore e shtimit natyrorë |
|---|---|---|
| 1981 | 40,522.00 | 2.90% |
| 1982 | 41,697.00 | 2.90% |
| 1983 | 42,906.00 | 2.90% |
| 1984 | 44,150.00 | 2.90% |
| 1985 | 45,431.00 | 2.90% |
| 1986 | 46,748.00 | 2.90% |
| 1987 | 48,104.00 | 2.90% |
| 1988 | 49,499.00 | 2.90% |
| 1989 | 50,934.00 | 2.90% |
| 1990 | 52,411.00 | 2.90% |
| 1991 | 53,721.00 | 2.50% |
| 1992 | 55,064.00 | 2.50% |
| 1993 | 56,440.00 | 2.50% |

| | | |
|---|---|---|
| 1994 | 57,851.00 | 2.50% |
| 1995 | 59,298.00 | 2.50% |
| 1996 | 60,780.00 | 2.50% |
| 1997 | 62,300.00 | 2.50% |
| 1998 | 63,857.00 | 2.50% |
| 1999 | 65,454.00 | 2.50% |
| 2000 | 66,789.00 | 2.04% |
| 2001 | 68,150.00 | 2.04% |
| 2002 | 69,685.20 | 1.97% |
| 2003 | 71,056.60 | 1.97% |
| 2004 | 72,455.00 | 1.97% |
| 2005 | 73,880.88 | 1.97% |
| 2006 | 75,334.84 | 1.97% |
| 2007 | 76,817.42 | 1.97% |
| 2008 | **78,300.00** | 1.97% |

Si bazë e llogaritjeve të mëtutjeshme është marrë vlera prej 78.300 banorë me shkallën vjetore të rritjes natyrore prej Sn=1.97%.
Vlerësohet se në vetë qytetin e Drenasit jetojnë mbi 9500 banorë. Pra, në komunë jashtë qytetit jetojnë rreth 68 800 banorë.
Vështruar nga përbërja gjinore, popullatën e Drenasit e përbëjnë: **51,3%** meshkuj dhe **48,7%** femra. Komuna është e banuar ekskluzivisht vetëm nga shqiptarët

## 2.2 Grup moshat e Popullsisë

Komuna e Drenasit ka një popullat kryesishtë të re,ku në përqindje sipas moshave janë:

- Struktura e popullsisë sipas moshës:
- -(0-15) (35.3 %),
- -(16-65) (59.9 %) dhe
- -mbi 66 vjet ( 4.8 % ).




**Fig. 5: Zhvillimi i grup moshave**
**Burimi: Statistikat Vitale të Kosovës 2002 – 2003 (ESK 2004), kalkulimet IWU për barazim të balancës së migrimit.**

## 2.3 Numri i vendbanimeve në komunën e Drenasit

Komuna e Drenasit përbëhet prej 44 vendbanimeve me 31 zona kadastrale,ku prej tyre: 36 fshatra, tri qendra urbane, 3 lokaliteteve dhe qendrës së Drenasit me gjithësejt **12914** objekte të banimit prej të cilave 12908 janë ndërtime të ulta ,kurëse vetem 14 prej tyre për momentin janë ndërtime të larta(mbi 12 m).

Komunën e përbejnë 10 Bashkësi lokale. Distanca e Bashkësive lokale nga qyteti i Drenasit është prej 0-15 km

Vendbanimet janë: Abria e Epërme, Bica, Tërdeci, Damaneku, Krojkova, Arllati, Llapushniku, Negroci, Gjergjica, Fshati i Bytyqve, Vuçaku, Nekoci, Kizhareka, Kamarani I, II, III, dhe IV, Zabeli i Epërm, Zabeli i Poshtme, Korrotica e Poshtme, Sankoci, Fushtica e Epërme, Fushtica e Poshme, Korrotica e Epërme, Pakleku i Vjetër, Pakleku i Ri, Vasileva, Gllogoci I dhe II, Çikatova e re, Gllabari, Shtrubullova, Çikatova e Vjetër, Lagja e Feronikelit, Tersteniku I dhe II, Palluzha, Shtutuica, Vërboci, Dabrasheci, Gradica, Likashani, Gllanasella dhe Gadanci.

Komuna ka një shpërndarje jo të pastër të vendbanimeve. Shumica e vendbanimeve gjenden në rrafshinë dhe janë zhvilluar përgjatë akseve rrugore çka e pengon zhvillimin e mëtutjeshëm. Drenasi është qendër lidhëse i të gjitha vendbanimeve komunale.

Nuk ka vendbanime të pa depërtueshme për shkak të kushteve topografike pos në rastet e vërshimeve apo borës .




**Harta.5. Vendbanimet dhe shtrirja e popullësis në Komunën e Drenas.**

Tab.7.Tabela që tregon nr.e vendbanimeve dhe popullatë

| Nr | Lokacioni | N.r i banorëve | Largësia-km | Koha e vozitjes(min) | Furnizimi me ujë | | | Ndërtesat E larta | | Shkollat dhe foshnjoret | | Ndërtesat publike | Stac. e derivative të naftës |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Nr.i hidranteve | Nr.i lumenjëve | Nr. i puseve | Nr. i ndërtesave | Shkallë emergj. | Nr.shkollave | Nr. i nxënësve | | |
| 1 | Abria e Epërme | 2842 | 15 | $0.40^{h}$ | 0 | 0 | 403 | 0 | 0 | 1 | 480 | 2 | 0 |
| 2 | Baica | 3228 | 7 | $0.20^{h}$ | 0 | 0 | 311 | 0 | 0 | 1 | 464 | 2 | 1 |
| 3 | Tërdec | 1760 | 12 | $0.30^{h}$ | 0 | 0 | 201 | 0 | 0 | 1 | 277 | 2 | 0 |
| 4 | Damaneku | 982 | 7 | $0.20^{h}$ | 0 | 0 | 133 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 5 | Krajkova | 852 | 7 | $0.20^{h}$ | 0 | 0 | 147 | 0 | 0 | 1 | 429 | 3 | 0 |
| 6 | Arllati | 3710 | 10 | $0.25^{h}$ | 0 | 0 | 147 | 0 | 0 | 1 | 449 | 3 | 2 |
| 7 | Llapushniku | 4158 | 8 | $0.20^{h}$ | 0 | 0 | 465 | 0 | 0 | 1 | 473 | 1 | 1 |
| 8 | Negroci | 1481 | 13 | $0.30^{h}$ | 0 | 0 | 219 | 0 | 0 | 1 | 418 | 1 | 1 |
| 9 | Gjergjica | 684 | 14 | $0.35^{h}$ | 0 | 0 | 106 | 0 | 0 | 1 | 46 | 1 | 0 |
| 10 | Lagjeja Bytyqi | 435 | 15 | $0.35^{h}$ | 0 | 0 | 47 | 0 | 0 | 1 | 309 | 1 | 1 |
| 11 | Vuçaku | 488 | 14 | $0.40^{h}$ | 0 | 0 | 53 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 12 | Nekoci | 3805 | 15 | $0.30^{h}$ | 0 | 1 | 397 | 0 | 0 | 1 | 645 | 2 | 2 |
| 13 | Kizhareka | 1933 | 13 | $0.25^{h}$ | 0 | 1 | 173 | 0 | 0 | 1 | 493 | 3 | 0 |
| 14 | Komarani I | 1989 | 7 | $0.10^{h}$ | 0 | 1 | 247 | 1 | 0 | 1 | 699 | 3 | 5 |
| 15 | Komarani II | 1735 | 9 | $0.12^{h}$ | 0 | 1 | 268 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 |
| 16 | Komarani III | 1085 | 9 | $0.15^{h}$ | 0 | 1 | 106 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 17 | Komarani IV | 243 | 7 | $0.15^{h}$ | 0 | 1 | 52 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 |
| 18 | Zabeli I Epërm | 461 | 9 | $0.15^{h}$ | 0 | 0 | 75 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 19 | Zabeli I Poshtem | 1178 | 5.5 | $0.08^{h}$ | 0 | 1 | 157 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 1 |
| 20 | Korrotica e Poshtem | 1079 | 4.5 | $0.07^{h}$ | 0 | 1 | 99 | 0 | 0 | 1 | 477 | 0 | 2 |
| 21 | Sankoci | 1531 | 12 | $0.25^{h}$ | 0 | 0 | 153 | 0 | 0 | 1 | 366 | 2 | 0 |
| 22 | Fushtica e Epërme | 1084 | 15 | $0.30^{h}$ | 0 | 0 | 110 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 23 | Fushtica e Poshtme | 1142 | 15 | $0.35^{h}$ | 0 | 1 | 137 | 0 | 0 | 1 | 243 | 1 | 0 |
| 24 | Korrotica e Epërme | 1934 | 12 | $0.20^{h}$ | 0 | 0 | 303 | 0 | 0 | 1 | 279 | 2 | 1 |
| 25 | Pakleku I Vjetër | 2503 | 5 | $0.08^{h}$ | 0 | 1 | 149 | 1 | 0 | 1 | 306 | 2 | 0 |

| | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 26 | Pakleku I Ri | 562 | 3.5 | $0.04^h$ | 0 | 1 | 57 | 3 | 0 | 2 | 3185 | 2 | 1 |
| 27 | Vasileva | 872 | 6 | $0.15^h$ | 0 | 0 | 109 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 28 | Drenasi I | 5638 | | $0.04^h$ | 2 | 1 | 155 | 7 | 0 | 1 | 1538 | 10 | 1 |
| 29 | Drenasi II | 4142 | 1.5 | $0.04^h$ | 0 | 1 | 170 | | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 |
| 30 | Çikatova e Re | 959 | 1.5 | $0.05^h$ | 1 | 1 | 307 | 3 | 0 | 1 | 437 | 1 | 0 |
| 31 | Gllobari | 1887 | 3 | $0.02^h$ | 1 | 1 | 147 | 0 | 0 | 1 | 387 | 1 | 2 |
| 32 | Shtrubullova | 1492 | 2 | $0.06^h$ | 0 | 1 | 187 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 33 | Çikatova e Vjetër | 1124 | 8 | $0.12^h$ | 0 | 1 | 189 | 1 | 0 | 1 | 254 | 1 | 1 |
| 34 | Lagja e Feronikelit | 583 | 1.5 | $0.12^h$ | 0 | 1 | 5 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 35 | Tersteniku I dhe II | 5044 | 5.5 | $0.12^h$ | 0 | 2 | 543 | 1 | 0 | 2 | 1072 | 5 | 1 |
| 36 | Palluzha | 1448 | 6 | $0.15^h$ | 0 | 1 | 335 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 |
| 37 | Shtutica | 1173 | 11 | $0.25^h$ | 0 | 0 | 119 | 0 | 0 | 1 | 253 | 1 | 0 |
| 38 | Vërboci | 1635 | 9 | $0.20^h$ | 0 | 1 | 170 | 0 | 0 | 1 | 250 | 2 | 0 |
| 39 | Dobrosheci | 1411 | 9 | $0.20^h$ | 0 | 1 | 180 | 0 | 0 | 1 | 501 | 2 | 0 |
| 40 | Gradica | 1215 | 15 | $0.25^h$ | 0 | 0 | 187 | 0 | 0 | 1 | 323 | 2 | 0 |
| 41 | Likoshani | 912 | 13 | $0.25^h$ | 0 | 0 | 187 | 0 | 0 | 1 | 0 | 1 | 0 |
| 42 | Gllanasella | 1604 | 10 | $0.20^h$ | 0 | 0 | 319 | 0 | 0 | 1 | 286 | 2 | 1 |
| 43 | Godanci | 264 | 13 | $0.25^h$ | 0 | 0 | 107 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |

### 2.4 Numri i të punësuarve,pa punësuarve dhe i pensionistve

Neve si komunë kemi një bashkëpunim të mirë me Zyrën komunale për punësim dhe Qendrën për punë sociale,prandaj të dhënat e marrura nga këto dy qendra do ti paraqesim në formë tabelare.

| Nr. | Numri i të punësuarve | Nr.i të papunësureve | Nr,i pensionistve |
|---|---|---|---|
| 1 | 5905 | 11829 | 5160 |
| | | | |
| Gjithës. | 5905 | 11829 | 5160 |

# 3. Të mirat materiale,kulturore dhe të ambientit

## 3.1. Vlerat e Trashëgimis Kulturore

Drenasi karakterizohet me trashëgimi me vlera të larta kulturore si kullat dhe lokalitetet arkeologjike të cilat për fat të keq nuk janë mbrojtur ligjërisht,të cilat po i paraqesim në form tabelare.

**Tab. 8 Trashëgimia Kulturore**

| Lloji | Lokacioni | Shënim |
|---|---|---|
| Kullë | Dritan, Lagja Avdylaj | E dëmtuar gjatë luftës |
| Kullë | Bletar, Lagja Binaku | |
| Kullë | Llapushnik | Kulla ku është strehuar Hasan Prishtina |
| Lokalitet Arkeologjik | Vërbovc, Afër lagjes Rrukiqi | Kala |
| Lokalitet Arkeologjik | Damanek, lagja Hoxha | Guri 2000 vjeqar |
| Lokalitet Arkeologjik | Kishnarekë | Kishë dhe Shpellë |
| Lokalitet Arkeologjik | Negrovc–Vuqak-Gradina | |

## 3.2.Trashëgimia Natyrore

Komuna e Drenasit është e pasur edhe me trashigimin natyrore,që paraqet një vlerë shumë të çmueshme për këtë trevë,të cilat po I paraqesim në formë tabelare.

**Tab. 1 Vlerat natyrore në territorin e Drenasit, të mbrojtura sipas vendimit të KK, nr.322-303**

| Lloji | Lokacioni | Kategoria |
|---|---|---|
| Trungjet e rrënjës | Nekovc | III, monument natyrorë botanik |
| Kompleksi i trungjeve të rrënjës | Negroc | III, monument natyrorë botanik |
| Trungjet e Shpardhit | Negroc | III, monument natyrorë botanik |
| Shpella e Kishnarekës | Kishnareka | III, monument natyrorë gjeologjik |
| Trungu i qarrit | Krajkovë | III, monument natyrorë botanik |
| Guri i Gradinës | Llapushnik | III, monument natyrorë gjeomorfologjik |
| Burimi i ujit mineral | Poklek | III, monument natyrorë hidrologjik |

| | | |
|---|---|---|
| Trungjet e dushkut "Gjashtë Lisat" | Likoshan | III, monument natyrorë botanik |
| Guri i Plankës | Dobroshec | III, monument natyrorë gjeomorfologjik |
| Trungjet e dushkut | Tërstenik | III, monument natyrorë botanik |
| Trungu i dushkut | Likoshan | III, monument natyrorë botanik |

### 3.3. Parqet nacionale,parqet natyrore rezervatet dhe sipërfaqet pujore

Komuna e Drenasit nuk posedon me parqe naconale,parqe natyrore dhe rezervate që janë të emertuara nga Kuvendi i komunës ndërsa është e begat me sipërfaqe pyjore,ku në të ardhëmen me një zhvillim ekonomik mund të që një pjesë e këtyre sipërfaqeve pyjore ku kapin sipërfaqen prej 10895,të shërbejn si parqe natyrore,si:Malet e Berishës,malet e Qyqavicës,lugina e Vërbocit etj.

### 3.4. Objektet për furnizim me ujë

Qytetarët e komunës së Drenasit furnizohen me ujë të pijshëm nga ujësjellësi i qytetit, ujësjellësit lokal dhe puset.

Nga pasuritë ujore në Drenas çdo banori i takojnë afër **1,44 m³** ujë në vit dhe vetëm 27 % të fshatrave janë të lidhura me rrjetin e ujësjellësit. Ujërat në Drenas shfrytëzohen për pije, për furnizim të industrisë, ujitje, etj.
Drenasi bën pjesë në rajonet me sasi të limituara të resurseve ujore .
Ujësjellësi kryesor që furnizon banorët e Drenasit është Bazeni I, që gjendet në afërsi të Feronikelit dhe burimit të fshatit Krajkovë. Gjatë periudhës 2000-2008, falë investimeve të Kuvendit të komunës dhe ndihmës së donatorëve të huaj dhe kontributit të qytetarëve janë ndërtuar këta ujësjellës : në Sankovc, Korroticë e Epërme, Kishnarekë, Paklek i Vjetër, Çikatovë e Re, Terstenik-I dhe II, Gllabar, Shtrubillovë,Krojkovë dhe Vërboc. Popullata tjetër e komunës me ujë të pijshëm furnizohet përmes puseve individual.
Rezervat e ujit në komunë u shtuan këtë vit - 2008, me lëshimin në funksionim të sistemit "Ibër-Lepenc"
Gjendja e rrjetave të ujësjellsit dhe kanalizimit në komunën tone janë:

- ujësjellsi publik dhe lokal ………………………….me gjatësi 71500m'
- rezervoari i qytetit për furnizim më ujë të pijës ……me vëllim 5000m³
- kanalizimi fekal …………………………………. me gjatësi 8.694.9m'
- gropat septike ……………………………………… me vëllim 720m³
- kanalizimi atmosferik ……………………………. me gjatësi 4634m'




**Harta nr,6.Burimet për funizim me ujë**

## 3.5. Zonat për prodhim Bujqësor

Komuna e Drenasit ka sipërfaqe prej 27,100 ha prej tyre 16,205 ha janë tokë bujqësore. Nën sistemin e ujitjes janë 5600 ha, ndërsa në 4960 ha është aplikuar masa e komosacionit si potencial i prodhimtarisë bujqësore. Bujqësia e kësaj komune ka qenë dhe është e organizuar në dy sektorë:

a) Sektori privat me 14,373 ha
b) Sektori shoqëror me 1,832 ha

**Tab. 7. Veçorit e tokës**

| Lloji i tokës | Sipërfaqja | Sektori privat | Sektori publik/ shoqëror |
|---|---|---|---|
| Tokë bujqësore | 16205 hektarë | 88.7 % | 11.3% |

Kushtet klimatike janë mjaft të përshtatshme, ku në këtë rajon ka një klimë të mesme kontinentale me dimra të ftohët dhe verë të ngrohtë. Temperatura mesatare vjetore është 10.6$^0$C, kurse shuma e temperaturave vjetore është 3,869

$^{0}$C. Muaji më i ftohët është janari me 0.8 $^{0}$C, kurse muaji më i ngrohët është korriku më 20.6 $^{0}$C. Sasia mesatare e të reshurave është afër 670 mm, kurse në sezonin e vegjetacionit (prej muajit të IV-IX) afër 330 mm. Lartësia mbidetare është prej 500-650m, ku rreth 46% të sipërfaqes gjendet në lartësinë mbidetare rreth 650m, e cila lartësi është njëra ndër më të përshtatshmet për zhvillimin e prodhimtarisë bujqësore.

*Zonat e Sipërfaqeve të punueshme bujqësore kryesisht janë më rrafshin e Komoranit dhe Krojkovës,pastaj arat e Gllobarit,Gllanasellës etj,që kryesisht mbillen me drithëra e shumë pakë me kulturat intensive.*




**Harta nr,7.Harta e Drenasit që tregon zonat e tokës bujqësore**

# 4. Numri i zonave dhe objekteve industriale

## 4.1 Lokacionet e zonave dhe objekteve industriale në raport me vendbanimin

Bartëse kryesore e zhvillimit të ekonomisë së Komunës së Drenasit ka qenë dhe është industria (në veçanti me aktivizimin e "Feronikelit", në vitin 1984), me një pjesëmarrje relativisht të lartë me 66.7 %, pastaj bujqësia, tregtia, hoteleria, komunikacioni, ndërtimtaria, zejtaria etj.(Burimi ZHEL 2008).

**Tab. 2 Subjektet ekonomike në komunën e Drenasit**

| Emri i subjektit afarist | Numri i punëtorëve | | Vërejtje |
|---|---|---|---|
| | Para vitit 1999 | 2008 | |
| NUSH "Feronikeli" | 2200 | **1180** | punon |
| Xehërorja me Gurthyes dhe Seperacion,Qikatove e vjeter | 120 | 60 | Punon |
| Seperacioni i gurëve " Trasing" | 98 | **92** | Punon |
| OP "Drenica" | 380 | 20 | Punon |
| Fabrika e konfeksionit "Kluz" | 318 | | Nuk punon |
| Ferma për majmërinë e viçave | 61 | | Nuk punon |
| Ferma e brojlerve | 120 | | Nuk punon |
| OTHPB "Veterinari" | 12 | 6 | Punon |
| OTHPB "Kosovatrans" | 96 | 15 | Punon |
| OTHPB "19 Nëntori" | 89 | | Nuk punon |
| Komunalja | 30 | 50 | Punon |

Në vitin 2004 ka filluar punën Qendra e Re Tregtare që ka 134 lokale tregtare-zejtare e që ka punësuar rreth 150 veta dhe pritet që të punësoj mbi 200 veta. Komuna ka realizuar këtë projekt në bashkëpunim me komunitetin e biznesit, ku komuna ka bashkë investuar me sigurimin e projektit, menaxhimin e projektit dhe dhënien e tokës ndërtimore me rentë si dhe me përfundimin e projektit është siguruar ndërmarrja publike "Drenasi" për menaxhimin e kësaj qendre ne mirëmbajtje dhe në sigurim të tij.

**Harta .10. Lokacionet e Zonave dhe objekteve industriale**



## 4.2. Strehimoret për strehim të përkohshëm për rastet emergjente

Në komunën e Drenasit nuk kemi strehimore të veqantë për këto raste,mirëpo Drejtorati për SHPE-cë, i ka paraparë këto objekte të përkohëshme për strehim emergjentë si në tabelen e më poshtme.

| Nr | Komuna | Lloji dhe lokacioni I strehimorës | Agjensioni administrativ | Kapaciteti për familje -Aktualisht- | Kapacitet për individ Aktualisht | Vërejtje |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Drenas | Halla e sporteve në shkollën fillore "Bashkimi" në Drenas | Kuvendi komunal Përkatsisht Drejtoria e Arsimit | 10 familje me nga 10 antar | 100 antarë | Përkohësishtë |
| 2 | Drenas | Depot e OP"DRENICA" | AKP-ja | 100 familje | 1000 antarë | Përkohësishtë |
| 3 | Drenas | Ish Kazerma e TMK-së | Kuvendi Komunal | 10 familje | 50 antarë | Përkohësishtë |

# 5. Kapacitet mjekësore publike dhe private

Shërbimet shëndetësore publike në Drenas kryhen në tri nivele: **në shërbimin parësor, shërbimin dytësor dhe në shërbimin tretësor.**
Organizimi institucional i Mjekësisë Familjare është i organizuar me sa vijon:
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare(QKMF) ofron shërbime shëndetësore 24 orë.
Qendrat e Mjekësisë Familjare(QMF) – ofrojnë shërbime shëndetësore gjatë ditëve të punës.
AMF – ofrojnë shërbime shëndetësore gjatë ditëve të caktuara (2 deri 3 herë brenda javës)

**Kapacitetet e sistemit shëndetësor të Drenasit**

Në komunën e Drenasit ekziston një Qendër Kryesore e Mjekësisë Familjare, e stacionuar në qytetin e Drenasit, ( përkujdeset për rreth **78300** banorë të Komunës, ku janë të punësuar **186** punëtorë), në përbërjen e së cilës funksionojnë 5(pesë) Qendra të Mjekësisë familjare:

- QMF- Komoran, punon në dy ndërrime. Përkujdeset për shëndetin e rreth 9000 banorëve, (orari i punës nga ora 8- 18)
- QMF- Trestenik, punon në një ndërrime. Përkujdeset për shëndetin e rreth 8000 banorëve, (orari i punës nga ora 8- 15)
- QMF- Baicë, punon në një ndërrime. Përkujdeset për shëndetin e rreth 2000 banorëve, (orari i punës nga ora 8- 15)
- QMF- Arllat, punon në një ndërrime. Përkujdeset për shëndetin e rreth 2500 banorëve dhe, (orari i punës , ora 8- 15)
- QMF- Gllanasellë, punon në një ndërrime. Përkujdeset për shëndetin e rreth 2000 banorëve, (orari i punës nga ora( 8- 15)

dhe 7(shtatë) QVF të cilat ofrojnë shërbime shëndetësore të përditshme , ndërsa mjeku këto qendra i viziton një apo dy herë në javë:

- QVF- Gradic, përkujdeset për shëndetin e 950 banorëve. Mjeku e viziton qendrën një herë në javë, (orari i punës çdo ditë nga ora 8- 15),
- QVF- Dobroshevc, përkujdeset për shëndetin e 750 banorëve. Mjeku e viziton qendrën një herë në javë, (orari i punës çdo ditë nga ora 8- 15),
- QVF- Vasilevë, përkujdeset për shëndetin e 1200 banorëve. Mjeku e viziton qendrën një herë në javë, (orari i punës çdo ditë nga ora 8- 15),
- QVF- Abri e Epërme, përkujdeset për shëndetin e 870 banorëve. Mjeku e viziton qendrën dy herë në javë, (orari i punës çdo ditë nga ora 8- 15),

- QVF- Sanokovc, përkujdeset për shëndetin e 1300 banorëve. Mjeku e viziton qendrën dy herë në javë, (orari i punës çdo ditë nga ora 8- 15),
- QVF- Terdevc, përkujdeset për shëndetin e 880 banorëve. Mjeku e viziton qendrën një herë në javë, (orari i punës çdo ditë nga ora 8- 15), dhe
- QVF- Nekovc, përkujdeset për shëndetin e 1500 banorëve. Mjeku e viziton qendrën 4 (katër) herë në javë, (orari i punës çdo ditë nga ora 8- 15). Numri i banorëve është marr nga vlerësimet e DSHMS.

Në Drenas ka vetem 1 mjekë për 235 banorë, që është për tre deri në katër herë më i ulët se standardet e shteteve në rajon
Kemi edhe shërbimet shëndetësore private dhe atë:Me **9** Ambulanta specialistke,**10** stomatologjike,**3** pediatrike,**1** gjinekologjike,**3** laboratore për analiza.Kemi edhe **6** Barnatore.

# 6.Infrastruktura shkollore

**Procesi edukativo arsimor në Komunën e Drenasit zhvillohet në të gjitha nivelet,prej atij para fillor e deri të ai parauniversitar**

**Institucionet arsimore:**

- *3 Çerdhe*
- *26 shkolla fillore me 11141 nxënës;*
- *2 shkolla të mesme me 3522 nxënës;*
-

## Gjendja e tashme:

| Edukatore | Fëmijë që janë në Qerdhe | Personeli administrativ | | Personeli ndihmës | | Gjithsej personel | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Numri | | Numri | | Numri | | Numri | |
| 18 | 144 | 2 | | 2 | | 22 | |

*Tabela Numri i shkollave fillore, nxënësit dhe proporcioni nxënës/shkollë në arsimin e obligueshëm (klasat 1–9), 2008/9*

| Numri i shkollave | Numri i nxënësve | Proporcioni nxënës/shkollë |
|---|---|---|
| A 28 ( 3 ndara) | 11141 | |

*Tabela Personeli arsimor në arsimin e obligueshëm sipas pozitës (klasat 1-9) 2008/9*

| Mësimdhënësit | | Personeli administrativ | | Personeli ndihmës | | Gjithsej personel arsimor | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Numri | | Numri | | Numri | | Numri | |
| 539 | | 29 | | 200 | | 568 | 768 |

*Tabela Numri i shkollave të mesme , nxënësit dhe proporcioni nxënës/shkollë në arsimin e e mesëm (klasat(X-XII), 2008/9*

| Numri i shkollave | Numri i nxënësve | Proporcioni nxënës/shkollë |
|---|---|---|
| A (2+1 par. e ndarë) | 3522 | |

*Tabela Personeli arsimor në arsimin e mesëm sipas pozitës (klasat (X-XII) (X-XIII)*

| Mësimdhënësit | | Personeli administrativ | | Personeli ndihmës | | Gjithsej personel arsimor | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| I-IX | X-XIII | Numri | | Numri | | Numri | |
| 568 | 162 | 34 | | 216 | | 730 | 216 |

Institucionet e arsimit në Drenas do të sigurojnë arsimim cilësor tërë jetësor, i cili do të jetë i pranueshëm për të gjitha moshat e nxënësve në mënyrë që individi ta shfrytëzojë tërë potencialin e vet intelektual në përparimin shkencor e teknologjik dhe socialo ekonomik të vendit.




**Harta.11.Vendndodhja e Shkollave në Komunën e Drenasit**

# 7. Infratruktura teknologjike dhe e komonikacionit

## 7.1 Infrastruktura rrugore në Drenas

Pozita e Lidhjes së Komunës së Drenasit me rruget magjistrale është mjaftë e mirë sepse është në udhëkryq të magjistraleve,dmth me magjistralen **M9** që lidhin Prishtinën me Pejen, magjistralen Komoran Skënderaj që e lidhë me pjesen veriore të Kosovës,magjistralen Komoran Grykë e Caralevës,që e lidhë Drenasin me pjesen Jugë-perendimore të Kosovës.




**Harta që tregon lidhjen e Drenasit me rrugët magjistrale të Kosovës**

## 7.2. Rrjeti i rrugëve në Drenas

*Më tepër se 30 automjete qarkullojnë sot nëpër rrugët e Drenasit për një min.* Transporti paraqet një aktivitet shumë të rëndësishëm të njerëzimit. Ky realizohet,kryesisht përmes rrugëve automobilistike që në komunën tonë janë mbi **35.5 km rrugë magjistrale** dhe rajonale,mbi **70 km rrugë të asfaltuara lokale,dhe mbi 25 km rrugë të pa asfaltuara.**

Transporti ajror i udhëtarëve për në vendet e huaja bëhet përmes aeroportit ndërkomëtar të Prishtinës, ndërkaq transporti përmes hekurudhës është ende i vogël në krahasim me nevojat e popullarës së Drenasit .

Rrugë magjistrale janë: **20 km**,

Rrrugë regjionale janë: **15.5 km**

Gjithsejtë rrugë magjistrale dhe regjionale janë : **30.5km**

Rrugë lokale të asfaltuara janë rreth :**145 km.**

Ura në rrugët magjistrale dhe regjionale të Drenasit janë :**6**

Gjatësia e tuneleve është afersisht:**1200 m, ai i Baicës dhe 200 m ai i Qikatovës se vjetër.**

### 7.3. Transporti hekurudhor

Në Drenas transporti hekurudhor është në nivel shumë të ultë të zhvillimit. Kjo është si pasojë e infrastrukturës së pazhvilluar hekurudhore. Momentalisht (viti 2008) nëpër hekurudhat e teritorit të Drenasit lëvizë vetëm një tren për transportin e banorëve dhe transportin e mallrave për nevojat e dhe KFOR – it dhe Feronikelit. Shpejtësia maksimale e lejuar vetëm në disa pjesë të hekurudhave është 80 km në orë, kurse në pjesët e tjera është edhe më e vogël. Mirëmbajtja e hekurudhave është në nivel të ultë, ato po dëmtohen nga mbikalimet e paautorizuara, nga ndërtimet ilegale në brezin hekurudhor dhe hedhja e mbeturinave në afërsi të tyre.




**Harta 10. Rrjeti i rrugëve në komunën e Drenasit**




**Harta e rrugëve të Drenasit.**

## 7.4 Transporti ajror

Nga aeroporti i Prishtinës udhëtarët udhëtojnë në destinacione të ndryshme në Evropë. Kjo mundësohet nga aviokompani të ndryshme ndërkombëtare dhe vendore. Numri i fluturimeve të realizuara nga aeroporti i Prishtinës ishte 4157, ndërkaq numri i udhëtarëve (shkuarje – ardhje) ishte 840 000 udhëtarë. Aeroportet - Në Kosovë sot ekzistojnë aeroporti civil në Sllatinë afër Prishtinës dhe aeroporti ushtarak afër Gjakovës. Ekzistojnë edhe 12 fusha ajrore - aerodrome bujqësore të Aviokosovës dhe një fushë ajrore e Federatës Aeronautike të Kosovës në Dumosh. Shumë prej aerodromeve bujqësore janë në gjendje të keqe fizike dhe pa përkujdesje.

# 8. Sistemi Elektroenergjetikë në Drenas

Komuna e Drenasit furnizohet përmes sistemit të lagëpërquesit **2 x 220** Kv nga Termocentralet e Kosovës.i cili kalon përmesë qendrës shpërndarëse që gjindet në Fshatin Gllanasell,dhe nga aty dy linja të lagëpërquesit vien deri tek Trafostacionet e Feronikelit.

Pra Drenasi furnizohet nga Trafostacioni i Feronikelit me kapacitet: **2 x 160 MVA**, përmes LP 35 kV me përques të Al-Çe me seksion 95 mm²,dhe përmes Lipjanit me LP 35 kV Al-Çe 95 mm².Përkundër investimeve të vazhdueshme që bënë KEK-u në përmirësimin e rrjetit elektroenergjetik, gjendja e tij nuk është e mirë, dhe nuk i përmbush kërkesat me norma evropiane teknike. Në territorin e komunës rrjeti elektroenergjetikë dhe trafostacionet kanë këtë përbërje:

| | | |
|---|---|---|
| Rrjeti 35 kV ka gjatësi prej | 75 km | Shtylla metalike |
| Rrjeti 10 kV ka gjatësi prej | 125 km | Shtylla betoni dhe druri |
| Rrjeti 0,4 kV ka gjatësi prej | 213 km | Shtylla nga druri |

**TS 35/10 kV me fuqi prej 8 MVA 3 copë**

| | | |
|---|---|---|
| TS 10/0,4 kV , fuqive nga | 1000 kVA | 1 copë |
| TS 10/0,4 kV , fuqive nga | 630 kVA | 13 copë |
| TS 10/0,4 kV , fuqive nga | 400 kVA | 9 copë |
| TS 10/0,4 kV , fuqive nga | 250 kVA | 19 copë |
| TS 10/0,4 kV , fuqive nga | 160 kVA | 61 copë |
| TS 10/0,4 kV , fuqive nga | 100 kVA | 30 copë |
| TS 10/0,4 kV , fuqive nga | 50 kVA | 5 copë |

Energjetika në kushtet bashkëkohore është një resurs i pazëvendësueshëm në kuptim të zhvillimit ekonomik, të ushtrimit të veprimtarive të tjera, të ngritjes dhe mbajtjes në nivel të standardit jetësor dhe të mirëqenies sociale në përgjithësi. Sot, sektori energjetikë nuk është në gjendje të bëjë një furnizim 24 orësh dhe bizneset e konsumatorët shtëpiakë ngarkohen me shpenzime shtesë duke përdorë gjeneratorë.

**Harta që tregon rrejtin ditributiv**




## 8.1. Gazsjellësi dhe naftësjellësi

Në Drenas nuk ka burime të Naftës dhe gazit që do të mund të shfrytëzoheshin,prandaj nuk ka edhe rrejtë të tyre.

## 8.2.Telekomunikimi

Në Drenas ekzistojnë dy objekte të postës për telefoninë fikse, dhe atë në Drenas dhe Bushat. I tërë territori i komunës është i mbuluar edhe me rrejtin e telefonis mobile nga të dy operatorët dhe atë të Valës 900 dhe IPKO-së. Konkurrenca në këtë lëmi, ka mundësuar shërbime më cilësore dhe çmime relativisht të arsyeshme.

Në telefoninë fikse janë bërë investime të reja duke bërë zgjerimin e rrejtit në drejtim të Komoranit dmth në:Sankocë,Kishnarek,Zabel,Korroticë. Sot ekzistojnë rreth 25 mijë para pagues të telefonisë fikse,kurse mbi30 mijë parapagues të telefonis Mobile (Operatori Vala dhe Ipko ). Zhvillimi i rrjetit të internetit është

ende në fazën fillestare edhe pse me përparim të dukshëm si dhe televizonit kabllovik.

### 8.3. Gjendja e deponive të karburanteve

Sipas evidencave të Drejtoratit për Shërbime Publike dhe Emergjencë, bizneset individuale në Drenas kanë ndërtuar 26 Pompa të karburanteve të lëngëta për naftë dhe benzin,dhe 5 pompa me butan gaz.Shumica prej tyre janë ndërtuar pa përfillur procedurat dhe dispozitat ligjore.
Por me qëllim të përmirësimit të gjendjes dhe zbatueshmërisë së ligjit është bërë shtytje pozitive në respektimin thelbësor dhe teknikë për mbrojtje dhe siguri nga zjarri.

### 8.4. Gjendja e Mjedisit

Deri para aktivizimit të NEW CO Feronikelit Drenasi ka qenë një ndër komunat më pak të ndotura në Republikën e Kosovës.Pjesa më e ndotur është hapsiara ku janë të ndërtuara këto objekte,prandaj ndotjet nga gazrat dhe pluhuri është nga Feronikeli,Gurthyesit dhe termocentralet të cilat shtrihen në pjesën verilindore të Drenasit (shih foto ).





Mjedisi ndotet edhe nga deponitë ilegale dhe mbeturinat e ndryshme.Ndotësit më të mëdhenj janë automjetet e vjetra dhe pa katalizator,numri i madh i pompave të benzinës të cilat se bashku me gurthyesit në Qikatovë të Vjeter,Korroticë të Epërme dhe në Baicë janë ndotës të të ambientit,po ashtu ndotja shkaktohet edhe nga bujqësia sidomos ndotja e ajrit nga përdorimi jo profesional i pesticideve në bujqësi.Mirëpo,ndotësi më i madh

në komunën e Drenasit është Feronikeli .Emitimi i grimcave që e ndotin ajrin janë mbetjet e feronikelit të cilat janë tepër shqetësuese për qytetaret ku një numër i madh i banorëve kanë filluar të shfaqen shenja të sëmundjeve të ndryshme e sidomos kancerit në mushkëri.Po ashtu shkalla e ndotjes se ujrave është në nivel shqetësues.Mjaft e shprehur është derdhja e vajrave të djegur në lumenj nga serviset e automjeteve.Ujerat e zeza industriale derdhen ne lumenj duke bërë ndotje të shkallës se lartë,mosnënshtrimi kontrollit sanitar të ujërave dhe puseve është po ashtu dukuri shqetësuese për banorët .

Vetit kimike dhe fizike të ujit që shfrytëzohet për pije temperatura,dendësia,ngjyra,kripshmëri,gazet etj,analizohen vetëm pjesrisht.

Riciklimi i ujrave industrial nuk bëhët.

Ndotjen e lumenjeve e bëjnë gjithashtu edhe rrjedha e ujërave atmosferike nga objektet industriale dhe ekonomike të cilat vijnë në këta lumenjë pa masa të trajtimit të nevojshme.

# 9. Vlerësimi i rrezikëshmerisë nga fatkeqësit natyrore dhe fatkeqësit tjera

## Përkufizimi i klasifikimit të rrezikut

**Rrezik Shumë i Lartë (ShL) –** janë rreziqe të klasifikuara si kryesore apo kritike, të cilat kërkojnë veprim të menjëhershëm. Ato mund të kenë gjasë (mundësi) të **lartë** apo të **ulët** të ndodhjes, por mundësia e pasojave nga këto rreziqe është e atillë sa që ato duhet të trajtohen me prioritet të lartë. Kjo nënkupton që duhet ndërtuar strategji për zvogëlimin apo eliminimin e tyre, gjithashtu duhet të bëhet parandalimi i tyre në formën e planifikimit shumë sektorial, ushtrimeve dhe trajnimeve për to, si dhe monitorimi i tyre në formë të rregullt. Duhet të kihet parasysh që planifikimi të jetë specifik për rrezikun përkatës në vend të atij të përgjithshëm.

**Rrezik i Lartë (L) –** këto rreziqe janë të klasifikuara si domethënëse. Ato mund të kenë gjasë të **lartë** apo të **ulët** të ndodhjes, por pasojat e tyre të mundshme janë mjaft serioze për të tërhequr vëmendjen e duhur pasi që të klasifikohen si të tillë. Duhet t'i kushtohet vëmendje zhvillimit të strategjive për zvogëlimin apo eliminimin e rreziqeve, gjithashtu duhet vendosur masat e parandalimit të tyre në formën e planifikimit shumë-sektorial (së paku në formën e planeve të përgjithshme), si dhe organizimi i ushtrimeve, trajnimeve për to dhe monitorimi i rregullt i tyre.

**Rrezik i Mesëm (M) –** këto rreziqe janë më pakë domethënëse, por mund të shkaktojnë çrregullim dhe shqetësim për kohë të shkurtë. Këto rreziqe duhet të

monitorohen për tu siguruar se ato menaxhohen si duhet dhe u kushtohet vëmendje e mjaftueshme sipas marrëveshjeve të planifikimit të përgjithshëm emergjent.

**Rrezik i Ulët (U) –** këto rreziqe edhe për nga gjasa e ndodhjes edhe për nga ndikimi nuk janë domethënëse. Ato duhet të menaxhohen duke përdorur marrëveshjet për planifikim të zakonshëm apo të përgjithshëm emergjent dhe kërkojnë monitorim dhe kontroll minimal përveç nëse vlerësimet pasuese tregojnë ndryshime substanciale që detyrojnë kalim në kategori tjetër.

## METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË RREZIKSHMËRISË

**a. Frekuenca e ndodhjes:**

- **Shumë e mundshme:** Mundësia afër 100% në vitin e ardhshëm.
- **E mundshme:** Mundësia midis 10 dhe 100% në vitin e ardhshëm, ose së paku një gjasë në 10 vitet e ardhshme.
- **Ka gjasa:** mundësia midis 1 dhe 10% në vitin e ardhshëm, ose së paku një shans në 100 vitet e ardhshme.
- **E pa mundshme:** Mundësia më e vogël se 1% në 100 vitet e ardhshme.
- **Tepër e pamundshme:** Mundësia një herë në 500 vite
- 

Efekti goditës në komunitet (shkalla e ashpërsisë), Karakteristikat

| Ashpërsia | Karakteristikat |
|---|---|
| **Katastrofë** | ▪ Vdekje të shumëllojshme<br>▪ Ndërprerja e plotë e objekteve/shërbimeve për 30 ditë apo më shumë.<br>▪ Më shumë se 50% e të mirave materiale të dëmtuara rendë. |
| **E Ashpër** (kritike) | ▪ Lëndimet dhe/apo sëmundjet rezultojnë në paaftësi të përhershme.<br>▪ Ndërprerja e plotë e objekteve/shërbimeve për së paku 2 javë.<br>▪ Më shumë se 25% e të mirave materiale të dëmtuara rendë. |
| E **Mesme** | ▪ Lëndimet dhe/apo sëmundjet nuk rezultojnë në paaftësi të përhershme.<br>▪ Ndërprerja e plotë e objekteve/shërbimeve për së paku 10 ditë.<br>▪ Më shumë se 15% e të mirave materiale të dëmtuara rëndë. |
| **E kufizuar** (mbrojtur) | ▪ Lëndimet dhe/apo sëmundjet nuk rezultojnë në paaftësi të përhershme.<br>▪ Ndërprerja e plotë e objekteve/shërbimeve për së paku 1 javë. |

| | |
|---|---|
| | ▪ Më shumë se 10% e të mirave materiale të dëmtuara rendë. |
| **E Ultë** | ▪ Lëndimet dhe/apo sëmundjet e trajtuara me ndihmën e parë.<br>▪ Humbje e vogël e standardit të jetesës.<br>▪ Ndërprerja e objekteve/shërbimeve kritike për 24 orë e më pak.<br>▪ Më pak se 10% e të mirave materiale të dëmtuara rëndë. |

## PROCEDURA E VLERËSIMIT TË RREZIKUT

### Pasojat e mundshme dhe kualifikimi i tyre

### Kualifikimi i pasojave dhe probabilitetit

| **I.Klasifikimi** | **Pasojat për jetë dhe shëndet (J)** |
|---|---|
| 1. **E parëndësishme** | Veç një dëm i rëndë, paaftësi e përkohshme |
| 2. **E kufizuar** (e ngritur) | Veç një dëm i rëndë, lëndim serioz |
| 3. **E mesme** | Një vdekje, disa lëndime serioze |
| 4. **Serioze** (Kritike) | Disa vdekje (<5), disa lëndime serioze (20), deri në 500 të evakuuar |
| 5. **Katastrofike** | Disa vdekje (>5), me dhjetëra lëndime serioze, më shumë se 500 të evakuuar |

| **I. Klasifikimi** | **Pasojat mbi pronat (P) ose ndërprerja (N)- harxhimet totale të dëmeve në EURO** |
|---|---|
